

<p><i>Acquis</i> së BE-sëqë synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare)  <b>CELEX : 32009L0090 DIREKTIVA 2009/90/KE TË PARLAMENTIT EUROPIAN DHE TË KËSHILLIT, datë 31 Korrik 2009 “Specifikimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin e gjëndjes së ujit”</b>  <i>(OJ L 201/36, 01.08.2009)</i></p>		<p>Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit)  <b>Projekt Ligj “Për Burimet Ujore”</b>          Shkalla e përafritimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit          Përputhshmëri e plotë          Përputhshmëri e pjesshme          I papërputhur          Shkalla e Përafritimit e pjesshme</p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projektaktit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafrohet kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafritimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafritimit. Kur përafritimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafritimi i plotë.
Neni 2, pika 1	‘kufiri i zbulimit’ do të thotë: sinjali output ose vlera e përqendrimit mbi të cilin mund të pohohet, me një nivel të deklaruar konfidence që një mostër është ndryshe nga një mostër bosh që nga një mostër		Neni 3, pika 28	28. “Kufiri i zbulimit” është sinjali i nxjerrë ose vlera e përqendrimit mbi të cilin mund të pohohet, me një nivel besimi të deklaruar se një kampion është i ndryshëm nga një “kampion	E Plotë	

	bosh që nuk përmban përcaktues të interesit;			blank” që nuk përmban përcaktues të interesit.		
Neni 2, pika 2	‘kufiri sasior’ do të thotë: një shumëfishim i deklaruar i kufirit të zbulimit në një përqëndrim të përcaktuar që mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme me një nivel të pranueshëm të përpikëmerisë dhe saktësisë. Kufiri sasior mund të llogaritet duke përdorur një standart ose mostër të përshtatshme dhe mund të sigurohet nga pika më e ulët e kalibrimin në kurbën e kalibrimin, duke përjashtuar boshllëqet;		Neni 3, pika 27	27. “Kufiri i kuantifikimit” është një shumëfishim i deklaruar i kufirit të zbulimit në një përqëndrim të përcaktorit që mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme me një nivel të pranueshëm saktësie dhe përpikëmerie. Kufiri i kuantifikimit mund të llogaritet duke përdorur një standard ose mostër të përshtatshme, dhe mund të merret nga pika më e ulët e kalibrimin në kurbën e kalibrimin, duke përjashtuar “kampionin blank”.	E Plotë	
Neni 2, pika 3	'pasiguria e matjes' do të thotë : një parametër jo-negativ që karakterizon shpërndarjen e vlerave sasisë që i atribuohen një madhësie të matur, bazuar në informacionin e përdorur.		Neni 3, pika 47	47. “Pasiguria e matjes” është një parametër jo negativ që karakterizon shpërndarjen e vlerave të sasisë të cilat po i caktohen një matjeje, bazuar në informacionin e përdorur.	E Plotë	
Premisa 1	Duhet të sigurohet cilësia dhe krahasueshmëria e rezultateve analitike të gjeneruara nga laboratorët e përcaktuar nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare për të kryer monitorimin kimik të ujit në përputhje me Nenin 8 të Direktivës 2000/60/KE. Standarti EN ISO/IEC-17025 për kërkesat e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve të		Neni 42, pika 1	1. Autoritetet përgjegjëse për monitorimin e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe zonave të mbrojtura, me qëllim garantimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së rezultateve analitike të gjeneruara nga laboratorët e caktuar për të kryer monitorimin kimik të ujërave në përputhje me nenin 41, pika 5 e këtij ligji, sigurojnë që të gjitha metodat e analizës, përfshi	E Plotë	Përcaktimet ligjore janë në përputhje me Nenin 8 të Direktivës 2000/60/KE ( neni 41 dhe neni 42 pika 2 e projektligjit)

	testimit dhe kalibrimit parashikon standartet e duhura ndërkombëtare për vlefshmërinë e metodave të përdorura të analizës.			metodat laboratorike dhe ato online që përdoren për qëllimet e programeve të monitorimit kimik të kryera në përputhje me nenin 41 të këtij ligji, të vërtetohen dhe dokumentohen në përputhje me standardin EN ISO/IEC-17025 ose standarde të tjera të barasvlershme që pranohen në rang ndërkombëtar.		
Neni 3	Neni 3 Shetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha metodat e analizave, duke përfshirë metodat laboratorike, në vend dhe on line, të përdorura për qëllim të programeve të monitorimit kimik të kryera nën Direktivën 2000/60/KE janë vërtetuar dhe dokumentuar në përputhje me standardin EN ISO/IEC-17025 ose standardeve të tjera ekuivalente të pranura në nivel ndërkombëtar.		Neni 42, pika 1	1. Autoritetet përgjegjëse për monitorimin e ujërave sipërfaqësorë, ujërave nëntokësorë dhe zonave të mbrojtura, me qëllim garantimin e cilësisë dhe krahasueshmërisë së rezultateve analitike të gjeneruara nga laboratorët e caktuar për të kryer monitorimin kimik të ujërave në përputhje me nenin 41, pika 5 e këtij ligji, sigurojnë që të gjitha metodat e analizës, përfshi metodat laboratorike dhe ato online që përdoren për qëllimet e programeve të monitorimit kimik të kryera në përputhje me nenin 41 të këtij ligji, të vërtetohen dhe dokumentohen në përputhje me standardin EN ISO/IEC-17025 ose standarde të tjera të barasvlershme që pranohen në rang ndërkombëtar.	E plotë	
Premisa 2	(2) Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e vlefshmërisë, të gjitha metodat e analizave të aplikuara nga Shtetet		Neni 42, pika 2	2. Kriteret minimale të performancës për metodat e analizës, përllogaritja e vlerave mesatare dhe sigurimi i kontrollit	E Plotë	

	Anëtare me qëllim të programeve të monitorimit kimik të gjëndjes së ujit, duhet të plotësojnë disa kriterë performance minimale duke përfshirë rregullat për pasigurinë e matjeve dhe për kufirin sasior të metodave. Për të siguruar krahasueshmërinë e rezultateve të monitorimit kimik, kufiri i përcaktimit të sasisë duhet të përcaktohet në përputhje me një përkufizim për të cilin është rënë dakort përgjithësisht.			të cilësisë të përmendura në pikën 1 të këtij neni, specifikohen në Rregulloren për monitorimin dhe vlerësimin e statusit të ujërave, siç përcaktohet në nenin 41, pika 5 e këtij ligji.		
Neni 1	Neni 1 Kjo Direktivë përcakton specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e gjëndjes së ujit në përputhje me Nenin 8(3) të Direktivës 2000/60/KE. Ajo përcakton kriteret minimale të performancës për metodat e analizave që do të zbatohen nga Shtetet Anëtare kur të monitorojnë gjëndjen e ujit, sedimentit dhe biotës si edhe rregullat për të treguar cilësinë e rezultateve analitike.		Neni 42, pika 2	2. Kriteret minimale të performancës për metodat e analizës, përlogaritja e vlerave mesatare dhe sigurimi i kontrollit të cilësisë të përmendura në pikën 1 të këtij neni, specifikohen në Rregulloren për monitorimin dhe vlerësimin e statusit të ujërave, siç përcaktohet në nenin 41, pika 5 e këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 1 të Direktivës (Neni 8(3) të Direktivës 2000/60/KE) është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (neni 42 pika 1 e projektligjit)